

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

### UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

*Sarande, me 19.03.2021*

Për : **Shoqërine "2 AT" Sh.p.k**                      **NIPT K14019001H**

Procedura e prokurimit : Kërkesë për propozim

Numri i referencës së procedurës : REF-85883-02-04-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : **“Blerje Hipoklorit Natriumi per kerkesat e Ndermarjes”**

Fondi limit : **3.160.200(tremilion njeqind gjashtedhjetemije e dyqind) leke pa tvsh**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 17, date 8 Shkurt 2021**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1.“Albania Distribution Chem” shpk NIPT L82203011N me oferte **2,954,100 (leke pa TVSH)**
- 2.“2 AT” shpk NIPT K07924803N me oferte **3,022,800 (leke pa TVSH)**
- 3.“ATLANTIK 3” shpk NIPT K22218003V me oferte **3,091,500 (leke pa TVSH)**
- 4.“EURO MEGA 2010” shpk NIPT K91624505A me oferte **3,091,500 (leke pa TVSH)**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit qe kane paraqitur operatoret ekonomike, rezultoi se 3 prej OE nuk i plotesonin kerkesat dhe kushtet e DST-se te hartuar nga AK.

Nga sa me siper KVO-ja konkludon se:

#### **1. Operatori Ekonomik “ Albania Distribution Chem” shpk**

#### **Kriteret e Vecanta te Kualifikimit**

##### **1. Per Piken 2.3.5**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE per plotësimin e këtij kriteri rezultoi se : OE nuk eshte prodhues, pasi ka autorizim nga kompania Italiane “Allchital S.R.L dhe si i tille duhet te plotësoj kërkesat e pikës b) te këtij kriteri, pra te paraqesi si dokumentacion me kete kompani nje **kontrate furnizmi apo kontrate bashkëpunimi** te noterizuar/përkthyer, per te garantuar se

kushtet e kontratës plotesohen, jo vetëm për sasinë e mallit që do furnizohet, e cila është përcaktuar në preventivin e hartuar nga AK, mënyra e dorzimit të mallit, kohën e furnizimit, **periudhën** për të cilën lidhet kjo kontratë, e domosdoshme për shoqëritë të tona, për të përmbushur me sukses dhe pa pengesa realizimin e kontratës me OE.

## 2. Për Piken 2.3.8

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, për plotësimin e këtij kriteri rezultojnë se :

1. Për mjedin me targë AA141 BI, nuk është paraqitur asnjë certifikatë transporti ndërkombëtar apo për transport brenda vendit të mallrave, e lëshuar nga institucionet përgjegjëse apo nga Bashkia përkatëse.
2. OE nuk vërtetohet se ka në pronësi ose me qira një automjet, i cili është i konfirmuar nga institucionet kompetente, me certifikatën (ADR) për “Transport Lende të Rrezikshme”. Për përmbushjen e këtij kriteri kërkohet që Automjeti special, të jetë i pajisur me certifikatë “**Transporti lende e rrezikshme -ADR**”, lëshuar nga institucionet përgjegjëse certifikuese, dhe jo certifikatë “**Certifikatë trajnimi -ADR**” të z. Sazan DRIZA që ka paraqitur OE, bashkëlidhur kontratës të mjedit të marrë me qira, pasi kjo certifikatë lëshohet vetëm për drejtuesit dhe jo për automjete speciale të transportit të lendeve të rrezikshme.

**Nga sa më sipër dhe në mbështetje të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 të ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “Albanian Distribution Chem” shpk, nuk është e suksesshme, pasi nuk përmbushen të gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se të hartuar nga AK.**

## 2. Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3”shpk

### **Kriteret e Vecanta të Kualifikimit**

#### 1. Për Piken 2.3.5

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE për plotësimin e këtij kriteri rezultojnë se : OE nuk është prodhues, pasi ka autorizim nga kompani Serbe dhe Kineze dhe si i tillë duhet të plotësojë kërkesat e pikës b) të këtij kriteri, pra të paraqesë si dokumentacion me këto kompani një **kontratë furnizimi apo kontratë bashkëpunimi** të noterizuar për të garantuar në kushtet e kontratës, jo vetëm sasinë e mallit që do furnizohet, e cila është përcaktuar në preventivin e hartuar nga AK, por dhe kohën e furnizimit, **periudhën** për të cilën lidhet kjo kontratë, e domosdoshme për shoqëritë të tona për të përmbushur me sukses dhe pa pengesa realizimin e kontratës me OE.

## 2. Per Piken 2.3.6

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se ky OE, nuk vërteton se eshte i regjistruar dhe i certifikuar per tregtimin e produkteve kimike, per trajtimin e ujit per konsum njerezor ne Komunitetin European.

## 3. Per Piken 2.3.8

Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se automjeti qe ka ne pronësi , eshte i konfirmuar nga instucionet kompetente, me certikaten (ADR) per “Transport Lende te Rrezikshme”.

**Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “ATLANTIK 3” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.**

## 3. Operatori Ekonomik “EURO MEGA 2010” shpk

### **Kriteret e Vecanta te Kualifikimit**

#### 1. Per Piken 2.3.1

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE per plotësimin e këtij kriteri rezulton se : OE ka dorëzuar, per përmbushjen e kesaj pike, “LEJE Mjedisi” te lëshuar nga QKL-ja dhe jo “Leje” per emërtimin përshkrues te veprimtarise me objekt aktivitetin, objektin e prokuruar ne procedurën ne fjale.

#### 2. Per Piken 2.3.4

Per përmbushjen e kësaj pike OE nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se produkti qe OE ofron, eshte i analizuar nga laborator i institucionit te “ISHP”-se si i vetmi organ përgjegjës, qe lëshon kete “Raport Analize” per produktin e kerkuar ne procedurën e prokurimit.

#### 1. Per Piken 2.3.8

Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka ne pronësi nje automjet, i cili eshte i konfirmuar nga instucionet kompetente, me certikaten (ADR) per “Transport Lende te Rrezikshme”.

**Nga sa me siper dhe ne mbeshtetje te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Nenit 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE "Euro Mega 2010" shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kerkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.**

**Duke u nisur nga sa me siper renditja e operatoreve ekonomik eshte si me poshte:**

- |  |              |
|--|--------------|
| 1. "Albania Distribution Chem" shpk Nipt. L82203011N | Skualifikuar |
| 2. " 2 AT" shpk Nipt. K07924803N.                    | Kualifikuar  |
| 3. "ATLANTIK 3" shpk Nipt. K22218003V                | Skualifikuar |
| 4. "EURO MEGA 2010" shpk Nipt K91624505A             | Skualifikuar |

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë: **"2 AT" Sh.p.k, NIPT K14019001H, Adresa : Korce-Dishnice, se oferta e paraqitur, me vlere : 3,022,800 (tremilion njezet e dymije e teteqind) leke pa Tvsh**

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni per nenshkrimin e kontrates, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **11.03.2021**

Ankesa : Nuk ka patur